



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 841/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Nenad Laziç, dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Adnan Imerit - Kandidatë për anëtar i Kuvendit Komunal nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Viti, paraqitur kundër personave nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Viti, për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 12.11.2013, mori këtë:

## **V E N D I M**

**HIDHET** si e palejueshme ankesa e Adnan Imerit - kandidatë për anëtar i Kuvendit Komunal nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Viti.

### **Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 12.11.2013, nga Adnan Imeri - Kandidat për anëtar i Kuvendit Komunal nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Viti, në të cilën pretendohet se në vendvotimet me nr. 2601D/01, 2601D/03, 2601D/03, 2601D/04, 2601D/05, 2601X/01, 2601X/02, 2601X/03, 2601X/04, 2601X/05, 2604D/01, 2604D/02, 2604D/03, 2605D/01, 2605D/02, 2605D/03, 2605D/04, 2608D/01, 2608D/02, 2611D/01, 2611D/02, 2616D/01, 2617D/01, 2617D/01, 2617D/03, 2621D/01, 2621D/02, 2621D/03, 2622D/01, 2623D/01, 2623D/02, 2623D/03, 2633D/01, 2633D/02, 2629D/01, janë manipuluar në këto forma: nuk janë numëruar të gjitha votat e kandidatëve të tjerë dhe votat e mia, janë plotësuar fletëvotimet e pa plotësuar që kanë qenë në kuti dhe kanë arritur votat alarmante të të gjithë kandidatët që vijnë nga radhët e të gjitha subjekteve politike me marrëveshjen në mes të kandidatëve dhe komisionarëve. Për më tepër ka shtuar se, të gjitha këto veprime janë kryer nga një grup i organizuar i personave që vijnë nga radhët e LDK-së, prandaj nga këto veprime jamë dëmtuar unë si kandidatë.

Parashtruesi i ankesës ka propozuar që të rinumërohen vendvotimet VV e lartcekura dhe të bëhet verifikimi i fletë votimeve për Kuvendin Komunal po ashtut të hetohen fletëvotimet që janë prishur me qëllim të caktuar

PZAP-i, shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

### **Ankesa është e palejuar**

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultatit preliminarë i shpallur nga KQZ-ja nuk është përfundimtar dhe mund të ndryshoj në çdo moment dhe po ashtu ankesa në fjalë për rezultat preliminar në vendvotim është dashtë të parashtrohet në PZAP nga anëtarët e komisionit të vendvotimit sipas nenit 102.1 të LZP-së parasheh se “Çdo anëtarë i komisionit të Vendvotimit që ka vërejtje në rezultatet e shënuara në një vendvotim mund të regjistroj mospajtimin tij në librin e votimeve të vendvotimit dhe mund të dërgoj një vërejtje te Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në përputhje me këtë ligj“. Në rastin konkret ankesa është parashtruar nga kandidati për anëtarë të kuvendit komunal që nuk është person i autorizuar sipas ligjit të parashtrë ankesë sipas dispozitës së lartcekur.

Bazuar në arsyet e sipërshënuar dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “PZAP-i, mund të hidh poshtë (si të palejuar, të parregullta apo të pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat të cilat janë të pabazuara, apo të cilat janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore”, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 841/2013 më datën 12.11.2013



**Këshillë juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.